

Autoriteti Bankar dhe I Pagesave te Kosoves

Në pajtim me autoritetin që i'u është dhënë sipas Nenit 17.b të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24 të datës 1 Tetor 2001 mbi Amandamentin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës si dhe Nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi Licensimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Udheheqës I Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 Mars 2002 adoptoi siq vijon:

Rregulli 2 në ndryshimin e Rregullit mbi Klasët e Sigurimit të Përgjithshëm të Njohura nga BPK-ja

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve të licencuar nga BPK.

2. Aspekti Ligjor

Rregullorja Kosovare për sigurime përshkruan që BPK-ja ka fuqinë të definoj klasët e ndryshme të sigurimeve të përgjithshme të cilat I njeh.

3. Klasat e Tanishme të Sigurimeve te Përgjithshme të njohura nga Autoriteti Bankar dhe I Pagesave të Kosovës

Sigurimet ndaj aksidenteve: mbrojtja financiare ndaj rrezikut të humbjes si pasojë e aksidentit.

Sigurimi bujqësor: I referohet sigurimit të të korrurave dhe bagëtisë.

Sigurimi I Aeroplaneve: mbrojtja financiare ndaj rrezikut të humbjes apo dëmtimit të aeroplaneve.

Sigurimi I përgjegjësishë ndaj palës së tretë në aeroplan: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që mund të shkaktojë detyrimet që rrjedhin nga rreziku i lëndimit ose vdekja e pasagjerëve ose individëve të tjerë për shkak të aksidentit të aeroplanit.

Sigurimi I kredisë: Mbrojtje financiare që mund të ketë dy forma. Sigurimi i kredisë së brendshme është mbrojtje financiare ndaj rrezikut që një debitor i brendshëm nuk do të ketë mundësi të paguaj borxhet e tij për shkak të paaftësisë paguese (insolvenca), problemeve financiare ose rreziqeve të tjera të definuara qartë. Sigurimi i kreditit të jashtëm është mbrojtje ndaj rrezikut që një debitor i jashtëm nuk do të ketë mundësi të paguaj borxhet e tij për shkak të paaftësisë paguese, problemeve financiare, arsyeve politike p.sh. imponimi i kontrollit të kapitalit, faktorëve ekonomik p.sh. imponimi i kontrollit të këmbimit ose rreziqeve të tjera të definuara qartë.

Sigurimi I të korruarave: Mbrojtja financiare ndaj rrezikut lidhur me pësimin e dëmtimit ose shkatërrimin e të korruarave bujqësore. Ky tip i sigurimit mund të bashkohet me sigurimin e bagëtisë dhe të quhet sigurimi bujqësor.

Gabimet dhe moskujdesia: sigurimi i përgjegjësive profesionale që dëmshpërblejnë palët e treta të cilat pësojnë apo provojn humbje financiare, dëmtim të pasurisë apo lëndime personale rrjedhin jashtë veprimeve (gabimeve) apo dështimi për të vepruar (heqjet) kur veprime të tilla normalisht janë të pritura nga marrëveshja profesionale me klientë.

Sigurimi I besnikërisë (besës): mbrojtja financiare ndaj rrezikut që ngritet nga besnikëria apo siguria e puntorëve.

Sigurimi I garancioneve: mbrojtja financiare ndaj rrezikut të mospagesës ku pagesa do të duhej bërë sipas kontratës. Ky sigurim është një ekuivalent me l gjerë se garancioni bankar ose letër me vlerë në pritje dhe e ngajshme me sigurim të garancionit.

Sigurimi Shëndetsor: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që rrjedh nga problemet shëndetsore. Ky sigurim mund të quhet edhe sigurim mjeksor ku faturat mjeksore mbulohen nga polisa e sigurimit.

Sigurimi mbi mbrojtjen e të ardhurave: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që të ardhurat e një personi mund të kërcnohen si pasojë e papunsisë, sëmundjes së gjatë ose paaftësisë.

Inland

Sigurimi I marinës së brendshme: mbrojtja financiare ndaj rrezikut nga humbja ose dëmtimi i mallërave në trupat në ujë që mund të konsiderohen të brendshëm p.sh. lumejtë, liqenet, disa detra.

Sigurimi I shpenzimeve ligjore: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që mund të ndodh në shpenzimet e papritura ligjore.

Sigurimi I bagëtisë: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që bagëtia të pësojë lëndime apo ngordhje. Ky tip I sigurimit mund të pakëtohet bashkë me sigurimin e të korrurave dhe të quhet sigurim bujqësor.

Sigurimi I marinës: mbrojtja financiare ndaj rrezikut mbi humbjen apo dëmtimin e të mirave në transit në trupa mbi ujë të cilët nuk konsiderohen të brendshëm, p.sh. oqeanet, shumica e detrave.

Sigurimi I përgjegjesisë ndaj palës së tretë në marinë: mbrojtja financiare ndaj rrezikut nga detyrimet që shkaktohen e që rrjedhin nga rreziku I lëndimit apo vdekjes së pasagjerëve të marinës ose individëve të tjerë si pasojë e aksidentit ku përfshihet anija e marinës. Ky tip I sigurimit mund të përshkruhet edhe për sigurimet e përgjegjësive ndaj palës së tretë në marinë të brendshme ose të dy tipet e rrezikut njëkohësisht.

Sigurimi mjeksor: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që shkakton fatura mjeksore të papritura si pasojë e shëndetit të ligë. Ky tip I sigurimit mund të quhet edhe sigurim shëndetsor.

Sigurimi i mbrojtjes ndaj pagesës së hipotekës: mbrojtja financiare ndaj rrezikut mbi mundësinë e mospagesës së hipotekës në kohën e duhur.

Sigurimi I autojmjeteve ndaj ndeshjeve: mbrojtja financiare ndaj rrezikut mbi humbjen apo dëmtimin e automjetit të specifikuar dhe/ose humbjen apo dëmtimin e automjetit të personit tjetër të përfshirë në ndeshje me automjetin e mbajtësit të polisës.

Sigurimi I përgjegjesisë ndaj palës së tretë në automjete: mbrojtja financiare ndaj rrezikut që shkaktohet nga detyrimi që ngritet nga rreziku I vdekjes apo dëmtimit të pasagjerit të automjetit ose individëve të tjerë si pasojë e aksidentit që përfshinë një automjet.

Sigurimi I dëmshpërblimit profesional: mbrojtja financiare ndaj padisë ligjore nga pala tjetër lidhur me dëmet nga shpërdorimi. Ky sigurim nganjëherë njihet si sigurim I gabimeve dhe shpërfilljeve.

Sigurimi I përgjegjësive profesionale: mbrojtje financiare për një broker sigurimi ndaj rrezikut për të qenë I paaftë për të përmbushur kërkesat profesionale dhe financiare që lidhen me pozitën e brokerit të sigurimeve.

Sigurimi I pasurisë: mbrojtje financiare ndaj rrezikut mbi dëmtimin apo humbjen e pasurisë. Ky sigurim mund të përfshijë mbulesë ndaj shumëllojshmërisë së reziqeve, p.sh. "të gjitha reziqet" ose një nga kombinacionet e reziqeve sic janë zjarri, grumbullimi I akullit, vjedhja, vërshimet, tërmetet, dëmtimet nga era, p.sh. tornadot, uraganët dhe vandalizmi.

Sigurimi I përgjegjësishë ndaj palës së tretë mbi pasurinë: mbrojtje financiare ndaj detyrimeve që shkaktohen nga rreziku që një person mund të lëndohet apo vdes në një pasuri të caktuar.

Sigurimi hekurudhor: mbrojtje financiare ndaj rrezikut mbi humbjen apo dëmtimin e pasurisë hekurudhore ose automjeteve hekurudhore.

Sigurimi I përgjegjësishë ndaj palës së tretë në hekurudhë: mbrojtje financiare ndaj detyrimeve që shkaktohen nga rreziku I lëndimit apo vdekjes së pasagjerëve të trenit ose ndonjë individi si pasojë e aksidentit duke përfshirë automjete hekurudhore.

Sigurimi I letër-garancionit (sigurisë) (Surety insurance): mbrojtje financiare ndaj rrezikut të mos-zbatimit të punës së definuar me kontratë. Ky sigurim zakonisht evidentohet nëpërmjet instrumenteve financiare. Ky sigurim është I ngjajshëm me sigurimin e garancionit.

Sigurimi i udhëtimit: mbrojtje financiare ndaj rreziqeve të ndryshme që lidhen me udhëtimet sic është anulimi I papritur I udhëtimit. Ky tip I sigurimit mund të përfshijë edhe elemente të sigurimit shëndetsor dhe të sigurimit të pasurisë.

Neni 2 Hyrja në Fuqi

Ky rregull duhet të hyjë në fuqi me 1 Prill 2002.

David Weatherman
Ushtrues I detyrës së Drejtorit Menaxhues